



KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më datë 29.08/2019, para meje notere Ardjana A. MEDIU, anëtare Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në adresën: Blv."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kat 7, u paraqitën personalisht:

Dhuruesi:

Z.Tomasso Scattolari, shtetas Italian, i biri i Mario-s, i datëlindjes 25.05.1980, lindur dhe banues në Cattolica (RN), ITALI, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikura prej meje me Pasaportë Italiane Nr.YA3123725, zotërues i 50 % të kuotës në Shoqërinë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k.

(në vijim referuar si "Dhuruesi");

dhe

Pranues i Dhurimit:

Z.Giuseppe Zito, shtetas italian, i biri Aniello-s, shtetës Italian, lindur më 03.12.1982, në Treviso (TV), banues në Via Cadore 3/c Trevignano (TV), Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje me Kartë Identiteti Italiane Nr. CA48030BG, zotërues i 50 % të kuotës në Shoqërinë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k.

(në vijim referuar si "Pranuesit i Dhurimit");

Të Përgjithshme

A.Shoqëria "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT-L82008014K, date 08.08.2018.

A. Tommaso Scattolari zotërues i 50 % të kuotës së Shoqërisë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k.

B. Giuseppe Zito zotërues i 50 % të kuotës së Shoqërisë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k.

I cili në përputhje me Ligjin "per Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" Nr. 7850 date 29.07.1994, Ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" dhe në përputhje dhe me Statutin e Shoqërisë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k.

Kërkuan redaktimin e kontratës së dhurimit të kuotës si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Dhuruesi bie dakort të transferoje nëpërmjet dhurimit në total 50 % të kuotës që zotëron në Shoqërinë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k, tek Pranuesi i Dhurimit, Z.Giuseppe Zito.

Neni 2

Gjendja e Kuotave

Kuota, objekt i kësaj kontrate, është plotësisht e disponueshme, e transferueshme, dhe e lirë nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barre tjetër ligjore.

Neni 3

Deklarimet dhe garancitë

Dhuruesi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron 50 % të kuotës që do të transferohet nëpërmjet dhurimit sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'a transferuar këtë kuotë dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.

Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Pranuesi i Dhurimit ka tagra të plota për të pranuar 50 % të kuotës, nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi i Dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi i Dhurimit.

Neni 4

Transferimi i kuotave

Transferimi i 50 % të kuotës që Dhuruesi zotëron ka efekt të menjëhershëm. Pranuesi i Dhurimit është mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve menjëhere pas nënshkrimit të këtij akti dhe rregjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Transferimi i pronësisë mbi 50 % të kuotës së Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kryhet nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe depozitimin e kontratës së dhurimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Pas transferimit nëpërmjet dhurimit të pronësisë mbi 50 % të kuotës së shoqërisë sipas kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kuotës në shoqëri do të jetë si vijon:

- Z.Giuseppe Zito zotëron 100 % të kuotës në Shoqërinë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k.;



Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotën në Shoqërinë "OTTO PUNTO OTTO" Sh.p.k, të zotëruar në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim nga të dy palët në rast të kundert do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Neni 7

Gjuha e Kontratës dhe Hyrja në Fuqi

9.1 Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale, dhe pasi ju lexua palëve në prezencë të perkthyeses së gjuhës italiane Znj. Joen Lumani, e datëlindjes 25.11.1993, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr. 031754771 dhe Nr. Personal J36125060K, u nënshkrua rregullisht prej tyre në prezencën time. Akti nënshkruhet dhe prej meje noteres.

9.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

Dhuruesi

Pranuesi i Dhurimit

Perkthyesë

NOTERE

Ardjana A. Mediu



REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---------------------------------|--------------------|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2019082916522571 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 29.08.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 4:52:02PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-005-459 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

TOMMASO MARIO SCATTOLARI
OTTO PUNTO OTTO SH.P.K.
GIUSEPPE ANIELLO ZITO

